

Nr	Komentet nga palët e interesit në draft “Raportin për Vlerësimin tri vjeçar të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë”	Përgjigjet e ZRRE-se në komente te palëve
Komentet e KOSTT-it		
1	<p><i>Mendojmë se në këtë Raport duhet të theksohet periudha e vlerësuar . Nëse është bërë një vlerësim para tri vitesh atëherë ky raport do të duhej ti referohej gjendjes prej 2011 -2014 ?</i></p>	<p>Ky raport i referohet periudhës së tri viteve të fundit. Për me tepër në kontekstin e hapjes së tregut duhet theksuar se nuk ka pas ndonjë ndryshim të gjendjes në raport me vlerësimin e konkurrencës të vitit 2011</p>
2	<p><i>Dizajni i Tregut do të duhej të trajtohej më tepër në këtë raport meqë ndërlidhet me temën. Është theksuar çështja: mos-shturja e furnizimit dhe distribucionit - tashmë është kryer kjo shturje</i></p>	<p>Vlerësimi për çdo tri vite nuk lidhet shume me provizionet e dizajnit të tregut. Dizajni i tregut nuk parasheh veprimet që duhet të merren për të hapur tregun, por vetëm parasheh obligimet e palëve në tregun konkurrues. Sa i përket mos-shturjes se furnizimit dhe distribucionit, ky dokument ka qenë i përgatitur para se të ndodh shturja, por pasi dokumenti është ende si draft, edhe kjo pjesë tashme është ndryshuar duke u harmonizuar me rrethanat aktuale pasi ndër kohë shturja është kryer</p>
3	<p><i>Në faqen e fundit thuhet se: deri tani nuk ka një metodologji për shfrytëzimin e sistemit të distribucionit - kjo metodologji është aprovuar</i></p>	<p>Dokumenti është modifikuar që të reflektoj këtë koment</p>

4

Faqe 6: Do të ishte mirë që indikatorët për koncentrimin e tregut të ipen në formë tabelore.

ZRRE konsideron se paraqitja e këtyre indikatorëve në tabelare do të ishte në interes nëse do të kishim numër të madh të kompanive me koncentrim të vogël në treg. P.sh indikator C3 kërkon koncentrimin e 3 kompanive të mëdha, ndërsa në Kosovë kemi vetëm një kompani. Prandaj konsiderojmë si të panevojshme paraqitjen e një kompanie në formë tabelare. Konsiderojmë se në dokument ky aspekt është përshkruar mjaftueshëm ku është thënë se shkalla e konkurrencës në Kosovë është e ulët, funksionon vetëm një gjenerator shtetëror (TC Kosova A, B) që dominon me afër 90% të tregut në Kosovë

Komentet e KESCO

1 Në RP, ZRRE-ja fokusohet në anën e "Tregut" të shitjes me pakicë për të përcaktuar nivelin e konkurrencës në furnizim. Duke ditur që aktualisht ekziston një burim i rëndësishëm i gjenerimit vendor dhe që në fakt të gjithë gjeneratorët e tjerë (hidro, energjia e erës etj) shesin 100% të prodhimit të tyre tek Furnizuesi Publik, mundë të konkludohet se tregu vendor i shitjes me shumicë nuk është konkurrues. Përderisa nuk ka një burim tjetër për prodhimin e energjisë, nuk ka konkurrencë për të formuar bazën për një treg konkurrues. Një tjetër fakt që duhet të merret parasysh është se nuk ka bazë për kapacitete të reja gjeneruese për të paktën pesë vitet e ardhshme në Kosovë, që nënkupton se Kosova do të jetë në mungesë të furnizimit. Kjo situatë nuk pritet të ndryshojë dukshëm në një të ardhme të afërt. Konkurrenca e tregut të shitjes me shumicë ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e tregut me pakicë.

Shpjegimi se të gjithë gjeneratorët vendor shesin 100% të prodhimit te furnizuesi publik me mungesën e konkurrencës në tregun me shumicë, nuk është plotësisht i saktë. Kjo çështje më shume ka të bëjë me rregullimin e tregut vendor me shumicë, sesa me mungesën e mundshme te konkurrencës.

ZRRE vlerëson se në të ardhmen mund të veprohet përmes një dizajni të ri tarifor që energjia elektrike në tregun vendor me shumicë të rregullohet: një pjese e energjisë të shitet në tregun me shumicë me tarifa të parregulluara, ndërsa pjesa tjetër të mbetet ashtu siç është tani. Një formë e tillë tashmë aplikohet në disa shtete në regjion (p.sh. Kroacia. Pra, është e mundshme hapja e tregut me shumicë me veprime konkrete dhe të kujdeseshe nga ana e ZRRE-së. Justifikimi tjetër i përmendur se edhe për 5 vitet e ardhshme do të ketë mungese të furnizimit me energji me pamundësinë e krijimit te tregut konkurrues me pakicë është vlerësim jo i drejt, për po të njëjtat arsye të theksuara më lartë. Promovimi i konkurrencës në tregun me pakicë do në kohën e duhur ku fillimisht ZRRE do te vlerësoj kostot e çmimeve në mes grupeve tarifore, mandej siç u përmend më lart një pjesë të energjisë të gjeneratorëve vendor do të shitet në tregun e lirë me tarifa të parregulluara. Këto veprime janë dëshmuar se përkrahin zhvillimin e një tregu konkurrues me pakicë.

2	<p>Konsumatorët e mëdhenj në përgjithësi kërkojnë shërbim cilësor dhe të pandërprerë, gjë që shton vlerën e operimeve të tyre. KESCO, si Furnizues Publik, mund të ofrojë vetëm këtë nivel të shërbimit (tjetër prej atij gjatë situatës emergjente) të konsumatorët e mëdhenj të kyçur në tension të lartë dhe të mesëm, nëse KESCO mund të planifikojë furnizimin e tij të përgjithshëm (blerjet nga gjeneratorët dhe importet) për një periudhë vjetore. Angazhimet duhet të bëhen paraprakisht deri në një vit për të pasur furnizim të qëndrueshëm në çmim të arsyeshëm. Si kthim për angazhimet e marra nga ana e Furnizuesit Publik, Konsumatorët e Privilegjuar duhet të angazhohen në kontrata të arsyeshme me kohëzgjatje një vit. Nëse kjo nuk ndodh, Furnizuesi Publik do të ballafaqohet me kosto që dalin nga të gjithë konsumatorët e tjerë, kjo situatë nuk është në interes publik.</p>	<p>ZRRE konsideron se të gjithë konsumatorët duhet trajtuar njëjtë. Furnizimi nga KESCO I konsumatoreve të mëdhenj nuk duhet të ndërlidhet me cilësinë e furnizimit. Cilësia e furnizimit më tepër i atribuohet si përgjegjësi e rrjetit të shpërndarjes; për më tepër të gjithë konsumatorët do të kenë tarifën e njëjta të shpërndarjes dhe të kyçjes që mundësohet përmes metodologjisë së taksave. Sa i përket planifikimit të përgjithshëm, kjo duhet të bëhet nga secili furnizues tjetër i pavarur, ku për të gjitha parashikimet do të vepohet në bazë të rregullave të tregut të cilat vlejné njëjtë për të gjithë furnizuesit e mundshëm që do veprojnë në tregun e Kosovës. Furnizuesi publik mund të ballafaqohet me ndikimin e daljes së konsumatorëve të furnizues tjerë, por kjo nuk mund të jetë kufizim apo pengesë për hapjen e tregut</p>
3	<p>Në përcaktimin e konkurrencës së tregut të shitjes me pakicë, veçanërisht atë që ka të bëjë me Furnizuesin e Pavarur kundrejt Furnizuesit Publik, KESCO inkurajon ZRRE-në që të marrë në konsideratë situatën e çmimeve në treg. Furnizuesi Publik aktualisht kërkohet që të furnizojë konsumatorët e Amvisërisë me tarifa më të ulëta se kostoja e furnizimit përderisa tarifën për kategoritë jo të amvisërisë (kategoritë industriale dhe komerciale) vendosen për të mbuluar më shumë se koston, ashtu siç përcaktohet me nivelet e përgjithshme të koston të vendosura nga ZRRE-ja. Kjo situatë është shumë dëmtoese në një treg konkurrues. Një jo-balancim i tillë krijon një situatë artificiale që Furnizuesit e Pavarur ta shfrytëzojnë këtë. Nëse furnizuesit e tillë shërbejnë konsumatorët profitabil të Furnizuesit Publik, atëherë do të mbetën vetëm disa shfrytëzues të tensionit të mesëm dhe shfrytëzuesit e mëdhenj të tensionit të ulët në mënyrë që të sigurohet subvencion për amvisëri. Situata e tillë nuk është në interes të publikut dhe ZRRE-ja inkurajohet që të racionalizojë tarifën ashtu që ato të jenë kosto reflektive për të gjitha klasat e konsumatorëve.</p>	<p>ZRRE gjithmonë në veprimet e veta ka për qëllim të mbroj në mënyrë të barabartë interesin e kompanive të rregulluara dhe njëkohësisht interesin e konsumatorëve. Pra me veprimet e mundshme në të ardhmen që të lëvizin çmimet drejt kostove reflektive për të mundësuar konkurrencën efektive në treg, ZRRE nuk ka arsye të mos merr parasysh të gjitha kostot e justifikuar për KESCO. Sa i përket ndërsuvencioneve ndërmjet grupeve tarifore, ZRRE do të veproj kujdesshëm, duke përmbushur kërkesat për konkurrencën që dalin nga TKE dhe bazuar në legjislacionin primar për energji</p>
4	<p>KEDS vazhdimisht gjatë procesit të shqyrtimit të tarifave ka kërkuar nga ZRRE që të lëviz drejt tarifave kosto-reflektive, me që qëllim të plotësimit të obligimit ligjor që tarifën të jenë kosto-reflektive nga 1 Janar 2015. Hapja e tregut duhet të bëhet në harmoni me lëvizjen e tarifave drejt principeve të reflektimit të kostove, ashtu siç është përshkruar në Nenin 40 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, i cili kërkon që fund të Dhjetorit të vitit 2014 ky proces të përfundojë. Sidoqoftë, ky harmonizim nuk është arritur, prandaj hapja e tregut do të rrezikoj ofruesit e shërbimit publik. KESCO e pranon se kjo nuk mund të bëhet e gjitha përnjëherë prandaj, e inkurajon ZRRE-në që të nisë gradualisht tarifën kosto reflektive që janë në fuqi në vendimin aktual të rishikimit tarifor para 1 prillit 2015.</p>	<p>Veni 40 I ligjit për energjinë elektrike nuk ka të bëjë me këtë çështje, por igji përcakton nevojën për fillim të hapjes së tregut nga 1 janar 2015 e në këtë edhe daljen e konsumatorëve nga furnizuesi publik të furnizues tjerë. Për më tepër vlejné komentet nën 2 dhe nën 3 më sipër</p>
<p>Komentet e ENCLO-Lindita Gashi</p>		

Pyetja ime është nëse ZRRE-ja ka ndërmend të japë rekomandime (propozojë masa) në këtë raport për 3 vitet e ardhshme që do të mundësojnë konkurrencë efektive në treg? Për shembull, a ka ndonjë afat kohor i imponuar për ndarjen e distribucionit dhe furnizimit dhe për metodologjinë për përdorimin e sistemit të shpërndarjes?

1 ZRRE duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Sekretariatit përmes "Udhëzimit të Politikave për reformat e modelit të tregut të energjisë elektrike, çmimet e rregulluara dhe reformës tarifore të energjisë elektrike të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë".

Në këtë raport ZRRE ka shqyrtuar konkurrencën në tregun e energjisë elektrike të Kosovës për tri vitet e fundit. Për të krijuar një treg efektiv konkurrues, ZRRE-ja do të veprojë në përputhje me ligjet primare për energji dhe i bazuar në detyrimet që rrjedhin nga TKE.

Sthurja e shpërndarjes dhe furnizimit tashmë është bërë.

Gjithashtu ZRRE ka miratuar metodologji e taksave për shpërndarjen, e cila do të mundësojë që kostot që të jenë transparente për të gjithë konsumatorët, dhe kjo është shumë e rëndësishme për rritjen e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë.

Komentet nga konsulentët Re-Power (projekti i financuar nga USAID-i)

<p>1</p>	<p>ZRRE tanimë i ka miratuar kriteret me të cilat vlerëson zhvillimin e konkurrencës in secilin treg përkatës. Si rezultat, ZRRE është zotuar që t’i përdorë ato kritere në vlerësimin se a duhet të jenë tarifat e rregulluara apo jo. Për konsistencë, ne i rekomandojmë ZRRE-së që të vazhdojë t’i zbatojë kriteret e njëjta e jo t’iu referohet matjeve të tilla si HHI ose C3 të cilat theksohen në Nenin 3 të këtij raporti. Sigurisht, nëse përgjigja në pyetjen se a furnizues të tjerë që shërbejnë në tregun përkatës është po, atëherë analiza e koncentrimit të tregut sikurse HHI ose C3 mund të zbatohet. Deri atëherë, megjithatë, ZRRE duhet t’iu përmbahet kriterëve të miratuar, për konsistencë.</p>	<p>Ky koment është marrë parasysht Brenda dokumentit</p>
<p>2</p>	<p>Raporti do të duhej të ketë ndonjë një referencë për bazën ligjore që rregullon çështjen në fjalë. Në këtë drejtim ne do rekomandonim referimin në këto nene:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 19.4 i Ligjit për Energjinë Elektrike i cili parasheh që të gjithë konsumatorët, përveç konsumatorëve të amvisërisë, janë konsumatorë të kualifikuar dhe se të gjithë konsumatorët do të jenë të kualifikuar duke filluar nga 1 janari 2015; - Neni 41.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë i cili parasheh se Tarifat për energjinë e furnizuar do të jenë të pa rregulluara kur energjia i shitet një konsumatori të kualifikuar.; - Neni 41.1.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë i cili parasheh se ZRRE-ja mund të vendosë tarifat të cilat u ngarkohen konsumatorëve të kualifikuar nga ndërmarrja e energjisë elektrike e cila është bartëse e licencës për furnizim publik vetëm kur Zyra nuk është e kënaqur me efektshmërinë e konkurrencës në furnizimin e energjisë elektrike; dhe, - Neni 41.1.3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë i cili parasheh se “Çdo konstatim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë se konkurrenca në furnizimin e energjisë elektrike nuk është efektive duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të publikuar të kushteve të tregut. 	<p>Në raport janë përfshirë nenet e referuara në koment.</p>

Vendim Bordit të ZRRE-së për kriteret e vlerësimit të konkurrencës (D_342_2011) thekson se vlerësimi nëse ekziston konkurrencë efektive do të kryhet në katër tregje të ndryshme përkatëse (Neni II i Vendimit).

3 *Ndonëse raporti cekë kriteret në nenin 6, ai nuk ofron një vlerësim real të numrit të furnizuesve në ato tregje përkatëse dhe përqindjen e tregut që ato e furnizojnë.*

ZRRE-ja ka vlerësuar vetëm gjendjen faktike në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, duke e vlerësuar konkurrencën në bazë të kriterëve të miratuara nga Bordi i ZRRE-së. Mjafton konkluzioni i theksuar në dokument ku ZRRE ka vlerësuar se ende nuk ka konkurrencë efektive në furnizimin me energji elektrike në Kosovë. Aktualisht, të gjithë konsumatorët të cilët e kanë statusin e konsumatorit të kualifikuar furnizohen nga i vetmi furnizues me tarifa të rregulluara. Arsyeja për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara është se në Kosovë, përveç Furnizuesit Publik, nuk operon asnjë furnizues tjetër i pavarur. Duke pasur parasysh se operon vetëm një furnizues, vlerësimi në dokument ofron vlerësim real.